



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/07  
Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni i Ministrave për Ndërmarrjet Publike, në këtë përbërje:
  - 1.1. Ministria e Ekonomisë, kryesuese;
  - 1.2. Ministri i Financave, anëtar;
  - 1.3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtare;
  - 1.4. Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, anëtar;
  - 1.5. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, anëtare;
  - 1.6. Ministri për Digjitalizim dhe Administratë Publike, anëtar;
  - 1.7. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar.
2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij Vendimi, do të paraqesë në Qeverinë e Republikës së Kosovës propozime dhe vërejtje lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 07/14, i datës 28.05.2021.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë